

VENDIM
Nr. 302, datë 24.4.2026

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2026, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT, PËR PËRBALLIMIN E
SHPENZIMEVE TË ORGANIZIMIT TË AKTIVITETIT KULTUROR-TURISTIK,
QË DO TË ZHVILLOHET NË TIRANË, NË DATËN 9 MAJ 2026, NË KUADËR TË
DITËS SË EVROPËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, në buxhetin e miratuar për vitin 2026, i shtohet fondi prej 15 627 900 (pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e nëntëqind) lekësh, në zërin 604 “Transferta të brendshme”, të programit 04760 “Zhvillimi i turizmit”, për përballimin e shpenzimeve operative të organizimit të aktivitetit kulturor-turistik, që do të zhvillohet në Tiranë, në datën 9 maj 2026, në kuadër të Ditës së Evropës.

2. Fondi prej 15 627 900 (pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e nëntëqind) lekësh përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2026.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama